



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



## Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

<b>Datë/Datum/ Date:</b>	08.05.2024
<b>Për/Za/For:</b>	<b>z. Imri Ahmeti</b> – Kryetar i Komunës së Lipjanit
<b>CC:</b>	<b>z. Diamant Bytyqi</b> – Nënkyetar i Komunës <b>z. Lulzim Qerimi</b> – Nënkyetar i Komunës
<b>Nga/Od/From</b>	<b>z. Rexhep Rexhepi</b> - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi
<b>Lënda/Subject/Subject:</b>	Raporti për Muajin Prill 2024

I nderuar Kryetar z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.04.2024 deri me 30.04.2024.

**Lipjan 2024**

### RAPORTI PËR MUAJIN PRILL -2024

#### PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

##### SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit prill kemi vazhduar sipas dinamikës së paraparë duke u angazhuar në maksimum në realizimin e detyrave dhe obligimeve që kemi si brenda institucionit gjithashtu edhe ndaj qytetarëve.

Më 29 prill është mbyllur afati i Ministrisë së Bujqësisë për programin për pagesa direkte, gjatë kësaj periudhe të aplikimit në komunën tone kanë aplikuar 1650 fermer për kultur të ndryshme.

Sipas komisionit të caktuar për projektin e subvencionimit të qumështit për fermerët blegtor, janë duke kompletuar lëndët për ti përcjellu për pages.

Gjithashtu edhe komisioni i caktuar për projektin apo subvencionimin e fermerëve për mekanizëm bujqësorë kanë shqyrtuar të gjitha lëndët dhe kanë dal me listen preliminare të përfituesve prej 250 sa është numri i përfituesëve.

Kemi dalur në teren për të pare rrugët e kategorisë së 4-të, të gjitha pregaditjet janë bërë dhe se shumë shpejt presim të fillojmë zhavorimin e tyre.

Në bashkpunimin dhe bashkëfinancimin që kemi me organizatën e QATAR charity, për hapjen e puseve, deri më tani kemi pasur mbi 80 kërkesa, ndërsa nga komisioni kanë kaluar mbi 35 familje më nevoj për hapjen e puseve dhe në proces janë edhe familje të tjera.

Jemi duke pruar lëndë të ndrshme nga fermerët të cilët kanë pasur dëme në kulturat e tyre apo edhe kërkesa të tjera të cilat komisioni nga drejtorati është duke i shqyrtuar dhe duke dalur në teren për ti parë dhe evidentuar dëmet.

Gjithashtu jemi në kontaktë të vazhdueshëm me operatorin I cili ka për obligimin trajtimin e qenëve endack konfrom kërkesave të qytetarëve, ku periudhen e fundit kemi intervenuar në disa lokacione brenda qytetit të Lipanit, fshatit Janjeve dhe Topliqan.

### **Raporti i shpenzimeve deri në muajin prill**

	Shpenzimet
Subvencione	2250
Mallra dhe sherbime	00